

# MASKA

Revista Elektronike  
Radio e RII në gjuhën shqipe  
Nr.4 Janar i vitit 2017.





## Mbështetja e vendeve arabe ndaj grupeve terroriste në Iran sipas dokumenteve angleze

Idhja e drejtpërdrejtë e Masud Raxhavi me regjimin Ba'th të Irakut kishte filluar dy vite përpara se pjesëtarët e kësaj organizate të nisen drejt Irakut, prandaj tregimi se ata ishin në kushte emergjente dhe ishin detyruar të vendosen me nguti në Irak, nuk është gjë tjetër vetëm një legjendë e trilluar.

Jehona e formimit të grupeve të egra terroriste në dokumentet e arkivave të Britanisë së Madhe duhet të ndahet në dy faza, para dhe pas fitores së Revolucionit Islamik të Iranit.

fitores së Revolucionit Islamik të Iranit, në raportet zyrtare perëndimore, sidomos në ato amerikane dhe britaneze, këto grupe të armatosura dhe terroriste të mëparshme, si dhe grupet e tjera të reja terroriste, nuk kujtoheshin për të keq, por ato quheshin "Forca të opozitës liridashëse kundër regjimit islamik të Iranit".

Kjo çështje përfshinte grupet e armatosura në Kurdistan, Khuzistan dhe në Shkretëtirën e Turkmenëve e deri tek grupet e njohura me emrat "Organizata e Guerilëve Fedajane Khalk" ose "Organizata Muxhahedine Khalk", ndërsa më vonë me këtë emër quheshin edhe grupet militante të armatosura të Shapur Bakhtjar dhe Gholamali Uvejsi në Irak. Përveç këtyre grupeve, edhe gjatë



Në vitet para fitores së Revolucionit Islamik, për arsye të marrëdhënieve të mira dhe strategjike që ekzistonin mes qeverive të Teheranit dhe të Londrës, në lidhje me ekzistencën e grupeve të ndryshme terroriste në Iran, me prirje të ndryshme, ekzistonte një ndjeshmëri dhe kundërshtim i veçantë dhe ato quheshin "Vrasës, terroristë të armatosur" dhe opozitarë të qeverisë legjitime të Iranit. Kjo është në kohën kur pas

pushtimit dhe pengmarrjës gjashtë ditore të përgjakshme në ambasadën e Iranit në Londër në fund të prillit dhe në fillim të majit të vitit 1980 nga mercenarët separatistë të partisë Ba'th të Irakut, shumë pak vërehet që autoritetet zyrtare të Britanisë së Madhe ti kenë quajtur "terroristë" pengmarrësit vrasës dhe mbështetësit e tyre të hapur të fshehur.

Kjo politikë e ndjekjes së standardeve të dyanshme nga Londra ka shkuar deri në atë masë sa që gjatë sulmeve terroriste më 27 qershor dhe më 29 gusht 1981, Qeveria e Britanisë së Madhe dhe vet Margaret Tacher, ish-kryeministrja konservatore e Anglisë në atë kohë, jo vetëm që nuk pranuan të dënojnë këto shpërthime terroriste vdekjeprurëse dhe autorët e tyre, por pas shumë polemikave brenda qeverisë, vendosen që të veprojnë përkundër protokolleve të zakonshme diplomatike duke mos ruajtur edhe sipërfaqësisht këto protokolle, nuk dënuan vrasjen e funksionarëve të lartë diplomaticë iranianë dhe nuk i shprehen ngushëllime autoriteteve iraniane.

Një politikë e ngjashme mund të vërehet në programet informative dhe analitike të mediave britaneze, sidomos të kanalit televiziv BBC, sidomos rrjetin ndërkombëtar dhe transmetimin e programit në gjuhën persiane të tij.

Trajtimi i shteteve perëndimore sidomos i Amerikës dhe Britanisë së Madhe me lëvizjet terroriste në Iran ose kundër Iranit, duhet të përcaktohet në tre mënyra. Mënyra e parë është mbrojtja e fshehur dhe e hapur e disa prej këtyre grupeve si për shembull lëvizjet pro regjimit mbretëror ose sekular që sipërfaqësisht paraqiten si nacionaliste dhe të cilat gëzojnë mbështetje të fortë dhe kryesisht të hapur dhe të qartë të autoriteteve të Uashingtonit dhe të Londrës.

Mënyra e dytë është mbështetja ndaj grupeve të tilla si organizata e ashtuquajtur Muxhahedine Khalk, të cilët edhe pse nuk duken të jenë nën mbështetjen zyrtare të autoriteteve perëndimore, mirëpo në praktikë ato kanë gëzuar të gjitha mundësitë potenciale dhe aktuale për zgjerimin dhe thellimin e veprimtarisë së tyre në shumicën e vendeve perëndimore në Evropë dhe Amerikë.

Këto grup në shumë raste kanë marrë edhe ndihma financiare dhe logjistike nën petkun e organizatave bamirëse. Këto ndihma janë siguruar edhe nga institucionet perëndimore edhe nëpërmjet qeverive arabe dhe Izraelit ndërsa janë ofruar nëpërmjet kanaleve perëndimore.

Lloji i tretë i mbështetjes përfshinë themelimin ose mbështetjen ndaj themelimit dhe zgjerimit të veprimtarisë së institucioneve sipërfaqësisht joiraniane mbuluese të cilat si institucione

joiraniane, kishin marrë detyrë lobimin politikë dhe në praktik ushtarak kundër Iranit. Përpjekjet e këtyre grupeve anti-iraniane janë bërë në periudha të ndryshme si në fillim të Revolucionit, gjatë luftës imponuese të Irakut kundër Iranit dhe pas saj, ndërsa vazhdojnë akoma në forma të ndryshme. Mirëpo në fund rrënja e të gjitha këtyre përpjekjeve ka për qëllim dobësimin e Iranit dhe të interesave kombëtare të Iranit dhe në fund rrëzimin e sistemit shtetëror të Republikës Islamike të Iranit.

Ajo çfarë kuptohet nga dokumentet zyrtare të perëndimore sidomos të arkivave britaneze, loja me kartën e minoriteteve etnike dhe fetare, me atë të organizatave separatiste dhe të grupeve terroriste, gjithmonë ka qenë në qendër të politikës së vendeve përball interesave kombëtare të Iranit. Këto veprime gjatë periudhës së luftës imponuese tetë vjeçare të Irakut kundër Iranit dhe pas një periudhe batica-zbaticash, në vitet pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, përsëri kanë hyrë në një fazë të re.

Kjo politikë ka shkuar deri në atë masë sa që pavarësisht kundërshtimit të familjeve të viktimave ushtarake amerikane që janë shkaktuar gjatë veprimeve terroriste të Organizatës Muxhahedine Khalk në vitet e 1970-ta, qeveritë e Britanisë dhe të Amerikës duke ndjekur politikën e standardeve të dyanshme, këtë grup terrorist e hoqën nga lista e organizatave terroriste.

Autoritetet evropiane dhe amerikane në arsyetimin e këtij veprimi çnjerëzor, kanë deklaruar se ky veprim është bërë në bazë të nevojës për të pasur një grup servil të armatosur dhe të përbetuar kundër Iranit me qëllim që të ushtrohet më shumë presion kundër Teheranit në drejtim të interesave të Perëndimit. Në këtë kuadër, nuk është përfillur aspak fakti se ky grup dhe grupe të ngjashme me këtë së bashku me liderët e tyre, a kanë legjitimitet ose kredibilitet në mesin e popullit iranian ose jo.

Organizatave terroriste, sidomos organizata Muxhahedine Khalk ka shumë vite që është nën mbështetjen e vendeve perëndimore, sidomos të lobeve brenda institucioneve shtetërore të Perëndimit. Këto ndihma nganjëherë janë bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hapur nën petkun e mbështetjeve ndaj veprimtarisë lridashëse dhe humanitare. Nganjëherë, këto ndihma janë dhënë në kuadër të faljes së taksave për aktivitetin tregtar

të kësaj organizate si një institucion bamirës dhe nganjëherë janë bërë në emër të ndihmës ndaj institucioneve mbuluese sipërfaqësisht evropiane dhe amerikane që duket se nuk janë të lidhura me Iranin.

Disa vende arabe që nga fillimi i Revolucionit Islamik, kanë kërkuar rrëzimin e Revolucionit dhe të sistemit shtetëror të Republikës Islamike të Iranit. Në krye të vendeve arabe që kanë vërë veprime të tilla mund të përmendet mbretëria suadite, regjimi Ba'th i Irakut, EBA, Bahrejni dhe Jordania.

Këto vende nëpërmjet ndihmave ndaj grupeve separatiste dhe armiqësore, kanë filluar punën e tyre që nga fillimi i Revolucionit Islamik. Pastaj i erdhi radha inkurajimit dhe nxitjes së regjimit ba'thist të Irakut për ta sulmuar ushtarakisht Irakun.

Kjo mbështetje dhe ky inkurajim ishte i hapur deri në atë masë sa që në fillim të luftës, ushtria e Sadam Husejnit në mënyrë të qartë deklaroi kërkesat e saj për të hequr dorë nga pushtimi i Iranit dhe për t'i dhënë fund luftës.

Këto kërkesa përfshinin ndarjen e provincës

Mirëpo sipas dokumenteve të publikuara së fundi, tani zbulohet se Organizata Muxhahedine Khalk ka luajtur një rol të rëndësishëm për të thithur ndihmat ndërkombëtare për Sadam Husejnin dhe për të thyer sanksionet dhe embargon botërore kundër tij.

Përveç kësaj, Organizata Muxhahedine Khalk për një periudhë të gjatë edhe merrte naftë falas nga Iraku, edhe luante rolin e shitësit të naftës së sanksionuar të Irakut duke vepruar në emër të kompanive formale dhe mbuluese perëndimore në tregjet botërore.

Natyrisht se kjo ishte përveç ndihmave të tjera të vendeve perëndimore dhe arabe që jepeshin për Organizatën Muxhahedine Khalk të cilat po vazhdojnë deri më tani. Nga ana tjetër, çështja e mbështetjes së drejtpërdrejtë e Organizatës Muxhahedine Khalk në shtypjen e kryengritjes së myslimanëve shiitë në jug të Irakut dhe e kryengritjes së kurdëve në veri të Irakut, është një çështje shumë e rëndësishme e cila nuk është trajtuar në mënyrë të gjerë deri më tani dhe kërkon një analizë të veçantë.



Khuzestan dhe dorëzimin e tre ishujve Tanabi i Madh, Tanabi i Vogël dhe Bumusa në Gjirin Persik nga ana e Iranit. Qeveria e Arabisë Saudite në kuadër të kësaj politike, në fillim të luftës i ka dhënë mbi 50 miliardë dollarë në mënyrë të drejtpërdrejtë Sadam Husejnit.

Në fazën tjetër, i erdhi radha mbështetjes materiale, logjistike dhe me armatim ndaj organizatës Muxhahedine Khalk. Shumë njerëz mendojnë se mbështetja e fuqive arabe dhe e regjimit Ba'th të Irakut ndaj grupit të Masud Raxhavi, kufizohet vetëm me ndihma materiale.

E vetmja çështje e mbetur është kjo që në bazë të dokumenteve britaneze të cilat janë publikuar së fundi, dëshmohet se lidhja e drejtpërdrejtë e Masud Raxhavi me regjimin Ba'th të Irakut kishte filluar dy vite përpara se pjesëtarët e kësaj organizate të nisen drejt Irakut, prandaj tregimi se ata ishin në kushte emergjente dhe të detyruar që të vendosen me shpejtësi në Irak, nuk është gjë tjetër vetëm një legjendë e trilluar.

**Dr. Maxhid Tafarroshi**



## Shpjegimi i termit “terrorizmi i verbër” përmes krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk

**T**errorizmi i verbër ishte një periudhë e

krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk nën projektin e quajtur “shkatërrimi i kolonës ushtarake të regjimit”, por nëse vërejmë dokumentet dhe shkrimet e MEK si dhe pohimet e terroristëve munafikë, e kuptojmë se ata me termat “kolona ushtarake” apo “eksponentët e regjimit” kanë si objektiv çdo person që ka dashuri për islamin dhe revolucionin.

Munafikinët, në termin “kolona ushtarake” përfshijnë çdo person që bëhet pengesë në rrugën e tyre dhe përveç kërcënimit ndaj punonjësve të organeve shtetërore të sistemit të Republikës Islamike të Iranit, ata realisht kërcënojnë të gjithë popullin iranian me qëllim që të shkatërrojnë bazat popullore të pushtetit islam. Një shembull i qartë i vijës kriminale dhe terroriste të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk është mesazhi i një prej krerëve kriminelë të MEK i quajtur Ali Zarkesh. Në këtë mesazh që u drejtohet përkrahësve të mashtruar të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, thuhet: “Drejtojini sa më mirë dhe sa më efektivisht goditjet tuaja ndaj armikut. Sulmoni të gjitha organet dhe institucionet që synojnë të forcojnë pozitën e Khomeinit. Goditni pa mëshirë institucionet dhe personat që forcojnë ekonomikisht regjimin dhe nëse keni mundësi, konfiskoni pasuritë e tyre. Asgjësoni pa mëshirë të gjithë ata që rrëmbejnë armët për mbrojtjen e regjimit dhe mos lejoni askënd të pengojë

përpyjekjet tuaja për rrëzimin e regjimit.” (cituar nga mesazhi i Ali Zarkesh)

Nëse rreshta e këtij mesazhi i bashkojmë me krimet dhe terrorret e kryera nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk, mund të krijojmë një imazh të qartë të qëllimeve të errëta të MEK. Këtu nuk bëhet fjalë për sulme kundër anëtarëve të ushtrisë iraniane, të Gardës Revolucionare apo të forcave vullnetare, por kërkohet goditja dhe shkatërrimi i të gjitha institucioneve dhe i personave qofshin të armatosur ose jo, të cilët përkrahin politikisht apo ekonomikisht revolucionin islamik, e duan islamin dhe nuk pranojnë të gjunjëzohen përballë sistemit sundues botëror. Ky është kuptimi i saktë i “lëvizjes nga poshtë-lartë” dhe i “shkatërrimit të bazave të pushtetit”. Në këtë kuadër, pjesëtarët e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, i martirizonin pa mëshirë punëtorët me motoçikleta, vetëm për shkak se nuk pranonin t’ua jepnin atyre motoçikletat. Mbi këtë bazë, munafikët pushkatuan para syve të fëmijëve bashkëshorten e një punëtori të thjeshtë e të ndershëm, vetëm për shkak se nuk ua hapi derën dhe u përpoq të mbronte familjen e saj. Për këtë arsye këta kriminelë sulmuan pa mëshirë dyqanet e njerëzve besimtarë dhe i martirizuan ata vetëm për shkak se kishin varur në mur portretin e Imam Khomeinit apo ajete Kur’anore. Kriminelët e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk vranë mësuesin e ri, sepse në çantën e tij kishte foto të imam Khomeinit, masakruan fëmijën në vend të babait, dogjën për së gjalli fëmijët, dhe me thika copëtuan trupin e një çobani të pafajshëm. Në logjikë e sëmurë të pjesëtarëve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk,

të gjithë këta persona të pafajshëm ishin “kolona ushtarake” e Republikës Islamike, sepse secili prej tyre në njëfarë forme pengonte realizimin e qëllimeve të Amerikës dhe të shërbëtorëve të saj munafikë. Dikush i pengonte këto qëllime duke mos dhënë motoçikletën, dikush duke mbrojtur shtëpinë dhe familjen, dikush duke shprehur dashurinë për Imam Khomeinin. Ky ishte kuptimi real i asaj që munafikët e quanin “kolona ushtarake e regjimit” dhe që u përpoqën ta zhduknin.



Lexuesi i nderuar në këtë pjesë të dosjes së zezë të krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, do të përballet me pohime tronditëse. Megjithëse këto pohime janë vetëm një pjesë e krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, por përmes këtyre pohimeve do të kuptojë se si u zbatua në praktikë vija terroriste e MEK dhe se çfarë krimesh djallëzore janë kryer nga terroristët për të shkatërruar “kolonën ushtarake të regjimit”. Në këto pohime do të vëreni zbatimin e asaj vije që u përcaktua në dokumentet dhe direktivat kryesore të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Këto nuk janë krime të veçuara e të rralla të MEK, por krime sistematike që dëshmojnë për një vijë të përgjithshme terroriste të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Projektimi i krimit, grabitja e makinave dhe motoçikletave, përgatitja e mjeteve dhe rrethanave të krimit, thirrja nëpër rrugë të zbrazëta, gjetja e viktimës apo sipas këtyre kriminelëve, e “subjektit të duhur”, përgatitja e rrugës së largimit nga vendi i krimit, kryerja e krimit dhe fshehja e gjurmëve. Ky është një imazh i thjeshtëzuar i asaj që këta terroristë të verbër e quanin “akt revolucionar”. Dimensione të tjera të krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk ishin hedhja e bombave dhe gazit lotsjellës nëpër shtëpitë e njerëzve, në dyqane e tregje të mbipopulluara, grabitja e armatosur e makinave, grabitja me armë e bankave dhe djegia e objekteve private e publike.. etj. Ata zënien e pritave nëpër rrugë të largëta e të zbrazura, sulmet ndaj automobilave dhe motoçikletave të njerëzve të thjeshtë, grabitjen e këtyre mjeteve dhe vrasjen e pronarëve të tyre e quanin “konfiskim revolucionar”. Kështu quhej edhe grabitja e bankave dhe vjedhja e pasurisë së qytetarëve të thjeshtë. Në fjalorin e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, hedhja e granatave dhe e shisheve me benzinë në banesat e njerëzve besimtarë quhej “akt revolucionar”.

Përveç krimeve të lartpërmendura, hasim në pohime të rëndësishme edhe në lidhje me korrupsionin moral të pjesëtarëve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Korrupsioni moral dhe mëkati janë pjesë e pandarë e karakterit të hipokritëve. Profeti i Nderuar i Islamit (savs) thotë: “Ndershmëria vjen nga besimi, ndërsa imoraliteti nga hipokrizia.” Ndërsa Prijësi i besimtarëve Hz.Ali (as) thotë:” Hipokriti (munafiku) nuk pastrohet nga mëkati dhe nuk largohet nga ai.” Korrupsioni moral, degjenerimi dhe marrëdhëniet e jashtëligjshme seksuale kanë qenë tepër të përhapura në radhët e pjesëtarëve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk

e sidomos në të ashtuquajturat celula ekipore. Në lidhje me këtë ekzistojnë shembuj të shumë degjenerimi që nga përdorimi i pijeve alkoolike, kumari, e deri tek kurvëria dhe orgjitë, të cilat nuk mundemi t'i publikojmë për të respektuar disa norma morale e fetare. Islami thekson aq shumë në ruajtjen e moralit të shoqërisë, saqë për të ruajtur shëndetin moral të shoqërisë nuk lejon publikimin e çështjeve që mund të bëhen shkak për përhapjen e degjenerimit dhe imoralitetit në shoqëri. Si rrjedhim, mund të publikojmë në mënyrë të mbuluar e shumë të kufizuar pohimet mbi qindra raste të imoralitetit dhe degjenerimit të pjesëtarëve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Të burgosurit e mashtruar nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk kanë pohuar shumë raste, të cilat janë vetëm një pjesë e vogël e korrupsionit moral të munafikëve, por që dëshmojnë qartë për karakterin e degjeneruar dhe katastrofik të këtij grupi terrorist. Është e natyrshme që ata persona që kanë kryer ato akte aq mizore e terroriste, të zhyten në llumin e degjenerimit, imoralitetit dhe mëkatis.

Këtë shkrim po e përfundojmë duke analizuar një pikë të ndjeshme në strategjinë e krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Në fjalitë që cituam nga dekreti “tre fazat e luftës së armatosur”, mësuam se pjesëtarët e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, pas tejkalimit të fazës së parë ë të dytë të terrorizmit, pra vrasja e funksionarëve të sistemit të RII dhe e njerëzve besimtarë, hynë në fazën e tretë të quajtur “çlirimi” dhe “kryengritja e përgjithshme”. Duke e quajtur të paevitueshme këtë fazë të tretë të luftës së armatosur, ata arsyetonin se faza e tretë duhet të fillojë pas realizimit të fazës së parë dhe të dytë të luftës së armatosur. Tashmë kur realizuan fazën e parë dhe të dytë duke derdhur gjakun e mijëra njerëzve të pafajshëm si Beheshti dhe Rexhaji dhe të mijëra iranianëve të thjeshtë, çfarë fituan pjesëtarët e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk? A mos arritën gjë tjetër, përveç zhdukjes, demaskimit, turpërimit dhe disfatës së turpshme? Historia e përgjakur e revolucionit islamik është dëshmitarja më e mirë e realizimit të përcaktimit të Zotit për fundin e hipokrizisë dhe hipokritëve. Përsa i përket grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk është e qartë se ky grup nuk ka asnjë pozitë jo vetëm tek populli iranian, por tek asnjë popull i botës dhe emri i këtij grupi anti-revolucionar dhe anti-islamik që po i afrohet zhdukjes, do të mbetet përgjithmonë përkrah kriminelëve, terroristëve dhe njerëzve të korruptuar të historisë.

**S**tudent, i papunë, ushtar, nxënës, president, punëtor, kuadër ushtarak, punonjës poste, kopshtar, shofer, nxënës fetar, dhe....

Nuk ishte e rëndësishme se çfarë pune bënte, nuk ishte e rëndësishme se nga ishte, nuk kishte rëndësi se çfarë niveli arsimor kishte, vetëm një gjë kishte rëndësi për tu regjistruar në listën e terrorit të MEK.

Siç thotë vetë MEK, karakteri fetar mjaftonte që të vritej dhe zhdukej në formën më të egër.

Në rrugët dhe rrugicat e Teheranit, kanë prerë qafat e njerëzve. E njëjta metodë që përdoret nga takfiristët selefistë sot në Egjipt dhe në Siri. Në këtë mënyrë kanë marrë jetën e 17 mijë iranianëve duke i ndarë ata përgjithmonë nga ky komb.

17 mijë njerëz të pastër të këtij kombi dhe vendi. Martiri dr. Muhamed Husein Beheshti, i cili ishte një komb më vete, së bashku me 72 kolegë të tij është terrorizuar në atë formë sa që imami i kombit tha: “ Për të më ka prekur më shumë pabesia dhe padrejtësia që i është bërë, pasi martirizimi për të është diçka e vogël”.

Ai ishte presidenti i vendit që qëndrojnë pushtet për më pak se 1 muaj. Pikërisht për këtë arsye ai u vendos në listën e terrorit të MEK.

Muhamed Ali Raxhai është i njohur mirë nga Bashkësia Ndërkombëtare. Raxhai është ai që këmbët e torturuara i vendosi në tavolinën e OKB gjatë fjalimit që po mbante.

Me këtë veprim ai u tregoi të gjithëve se çfarë krimesh ka bërë shteti irakian si xhandari i rajonit i mbështetur nga Amerika.

Ai ishte myfti shkollë dhe profesor universiteti, por edhe ai u terrorizua dhe u vra përballë universitetit të jurisprudencës.

Nuk kishin kaluar më shumë se 6 muaj nga vrasja dhe terrorizmi i martir Murteza Motaharit dhe ata vranë edhe studentin anëtar të Institutit Islamik, d.m.th. Mehdi Rexhep Bejgi.

Ai u vra më 27 shtator të vitit 1981 në rrugën Saba të Teheranit.

Mesa duke MEK kishte arsytim bindës për vrasjen e Rexhep Bejgi.

Rexhep Bejgi shumë shpejt arriti të njohë grupin MEK dhe u largua për të ndjekur rrugën e imamit, rrugë që demaskoi imperializmin dhe hegjemonizmin dhe ngriti fortesën e tevhidit.

Mirëpo MEK nuk u ngop duke pirë gjakun e të rinjve të këtij kombi dhe ai mori jetën e qindra Muhamed Huseinëve, qindra Muhamed Alive dhe qindra Mehdivë të tjerë.

MEK duke ndryshuar rrobat e tij dhe i veshur si kopshtar, mori jetën e Sajad Shirazi që në atë kohë ishte një prej komandantëve më të mëdhenj të ushtrisë së Iranit.

Së bashku me të, MEK ka marrë jetën e qindra e mijëra njerëzve të tjerë, për të vetmin faj të tyre se ishin fetarë.

Mijëra burra, gra dhe të rinj të cilët nuk donin t'i kthenin shpinën imamit të tyre.

17 mijë njerëz u terrorizuan. Në atë anë të vendit ekziston gjithmonë një e keqe dhe shtab i pestë (MEK) që dikush përkujdeset për të.

Nuk e fusin në listën e grupeve terroriste dhe nëse e fusin e nxjerrin përsëri dhe e mbështesin.

Gjithë këta njerëz të vvarë, gjithë këto jetë të marra, gjithë kjo dhimbje dhe vuajtje, vallë e paska kaq të vështirë Bashkësia Ndërkombëtare që tu japë të drejtat e njeriut 17 mijë iranianëve që janë vvarë dhe martirizuar?!

Vallë Ahmed Shehid, reporteri special i OKB për të drejtat e njeriut në Iran, nuk mund të hapë një dosje për këta martirë iranianë?!

Një herë e një kohë një komandant i ushtrisë turke u dënua me vdekje vetëm sepse kishte në



mendje të kryente grusht shteti ndaj shtetit të mbështetur nga Amerika dhe Evropa të Rexhep Taip Erdogan, mirëpo asnjë nga organizmave ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut nuk ka reaguar dhe askush nuk e dërgoi Turqinë në KS të OKB për shkeljen e të drejtave të njeriut.

Në Siri armatosin të “keqen” që ajo të vrasë njerëzit.

Në Egjipt seleftistët i lejojnë të vrasin civilët. Zotëria e tij Mbreti në Bahrejn ka krijuar një lum gjaku.

Sauditët në Katif njerëzit i kalojnë nga brisku i mprehtë.

Mirëpo ç'bën Bashkësia Ndërkombëtare? Vetëm hesht.

Mianamri ndan gjymtyrët nga trupat e njerëzve dhe ato i dërgon në Nju Jork për të marrë çmimin Nobel për paqe.

Irani sot kërkon dëmshpërblimin për 17 mijë martirët që i janë rrëmbyer këtij kombi, për gjakun e 80 mijë vëllezërve e motrave që kanë humbur jetën në Irak, Siri dhe Bahrejn, për gjakun e derdhur nga viti 1948 e deri më sot në Palestinë dhe për gjakun e të gjithë atyre për të cilën në OKB nuk ka dosje.

Ne duam që e keqja të dënohet. Mirëpo nuk frikësohemi aspak nga e keqja.





F

illimi i rebelimit të armatosur dhe terrorit

Më 13 korrik 1982 në shpërthimin e ndodhur në selinë e Komitetit qendror të partisë Republika islamike, u martirizua Ajetollah Beheshti dhe mbi 72 funksionarë të sistemit të RII. Autori i këtij shpërthimi ishte një nga anëtarët e infiltruar e organizatës i quajtur Mohamed Reza Kolahi. Megjithëse goditja ishte shumë e rëndë dhe Bani Sadr dhe Raxhavi prisnin që me këtë goditje, sistemi i Republikës islamike të destabilizohej plotësisht, me përkrahjen e gjithanshme të popullit dhe me praninë masive në ceremoninë e funeralit të dëshmorëve, të gjitha shtresat e shoqërisë u përfshinë nga vala e irritimit ndaj akteve terroriste të organizatës Moxhahedin-e Khalk. Vrasja e Ajetollah Beheshtit për herë të parë u planifikua në vitin 1974 nga anëtarët e Komitetit qendror të organizatës. Ndjeshmëria ndaj këtij personi dhe përpjekja për eliminimin shpirtëror dhe fizik të Ajetollah Beheshtit, u trashëguua tek lidershipi i Masud Raxhavi që nga koha kur organizata kryesohej nga Teki Shahram. Që prej një muaji, Bani Sadri së bashku me krerët e organizatës Moxhahedin-e Khalk qëndronte i fshehur në një nga banesat e celulave të organizatës dhe atje prisnin që të shpërthente rebelimi i armatosur dhe populli të vriste krerët e sistemit e të dilte nëpër rrugë në përkrahje të organizatës dhe në këtë mënyrë, me protesta masive të arrihej rrëzimi i pushtetit. Por, reagimi i gjerë popullor dhe pjesëmarrja masive e popullit në tubimet që kryheshin në mbrojtje të Imam Khomeinit dhe shokëve të tij, si dhe zgjerimi i urrejtjes popullore ndaj akteve terroriste të aleancës Bani Sadr-Raxhavi, dëshmuuan se pritjet e tyre ishin krejtësisht të gabuara. Në veçanti, pjesëmarrja masive dhe entuziaste e popullit në zgjedhjet presidenciale që çuan në zgjedhjen e Mahmud Ali Raxhai në postin e presidentit, nuk lanë asnjë vend për optimizëm për aleancën Bani Sadr-Raxhavi. Në orën 11 të pasdites të 28 korrikut 1982, Bani Sadr dhe Masud Raxhavi, duke shfrytëzuar elementë të infiltruar të organizatës në forcat ajrore, u larguan nga Irani me një avion cisternë Boeing të forcave ajrore, piloti i të cilit ishte

kolonel Maezi, ish pilot personal i Shahut. Avioni u ul në një aeroport ushtarak të Parisit dhe qeveria franceze u dha azil politik Bani Sadrit dhe Masud Raxhaviut. Edhe Raxhavi edhe Bani Sadr theksuan se nuk kanë mbetur më shuëm se dy muaj deri në rrëzimin e pushtetit në Iran. Raxhavi emëroi Musa Jabani si zëvendësues të tij në Iran. Më katër shtator 1982, Mohamed Ali Raxhai i cili pas shkarkimit të Bani Sadrit, ishte zgjedhur president i RII dhe Mohamed Xhevad Bahonar, kryeministër i Iranit, u martirizuan nga një shpërthim që ndodhi në selinë e kryeministrit. Bomba ishte vendosur nga një elemente i infiltruar i organizatës me emrin Masud Kashmiri. Plani fillestar i organizatës ishte që bomba të shpërthente në banesën e Imam Khomeinit, por pasi ky plan nuk u realizua, bomba u vendos në selinë e kryeministrit. Më vonë, Raxhavi në një takim sekret me gjeneral Habush, kryetar i shërbimit informativ të Irakut, theksoi se: "... Megjithëse Shtëpia e Bardhë dhe Chamb Elize e dinin. Ne ishim në kontakt me Chamb Elize dhe ata e dinin se cili ishte autori i sulmit në selinë e partisë Republika islamike dhe cili vendosi bombën që vrau presidentin dhe kryeministrin e Iranit. Ata e dinin dhe e dinin shumë mirë, por nuk na quajtën terroristë". Që nga ajo kohë, organizata filloi të ndërmerre veprime të habitshme, duke u përpjekur të tërheq të rinj dhe adoleshentë të mashtruar, të cilët ndaheshin në grupe prej 25 personash, që shpërndaheshin nëpër lagje dhe rrugë të ndryshme, duke i bërë thirrje popullit të ngrihet për të përmbysur pushtetin! Një nga këto veprime ishte protesta e armatosur e 15 tetorit 1982, kur anëtarë dhe simpatizantë të armatosur të organizatës realizuan protesta në disa zona të Teheranit, por një numër i madh prej tyre u arrestuan nga forcat e rendit në bashkëpunim të ngushtë me popullin. Për shkak të përkrahjes së gjerë të popullit për pushtetin dhe të urrejtjes së madhe popullore për organizatën dhe lidershpin e saj, forcat e rendit arritën me shpejtësi të marrin gjendjen nën kontroll dhe të zbulojnë bazat dhe celulat e organizatës njëherë pas tjetrës. Anëtarët dhe simpatizantët e organizatës të shtyrë nga urrejtja që u ishte injektuar në mendjet e tyre, filluan të vrisnin njerëzit e thjeshtë dhe vetëm në Teheran u vranë qindra njerëz të thjeshtë si tregtarë, mësues, punëtorë,

etj., të cilët u masakruan vetëm për shkak të pamjes së tyre të jashtme. Në atë periudhë, për vrasjen e një dyqanxhiu të thjeshtë, mjaftonte



që ai të mbante në dyqanin e tij një foto të Imam Khomeinit. Gjatë dy viteve 1982, 1984, vetëm në Teheran u regjistruan 366 vrasje të njerëzve të thjeshtë nga anëtarët e organizatës Moxhahedin-e Khalk. 53 % e këtyre personave ishin punonjës të institucioneve shtetërore, të tillë si inxhinierë, mësues e nëpunës të thjeshtë, të cilët vetëm për shkak të pamjes së jashtme myslimane, u bënë viktimat e anëtarëve të organizatës. Skuadrat vrasëse vunë në shënjestër edhe imamët e xhumasë dhe u martirizuan personalitete si Ajetollah Saduki, imami i xhamisë së Jazdit, Ajetollah Dastkeib, imami i xhamisë së Shirazit, Ajetollah Madani, imami i xhamisë së Tabrizit, të cilët në atë kohë ishin mbi moshën 70 vjeçare. Por njëkohësisht, nën goditjet e fuqishme të forcave të rendit dhe të forcave popullore, organizata po dobësohej. Më 9 shkurt 1983 u zbulua banesa kryesore dhe selia e Komitetit qendror të organizatës dhe në sulmin e forcave të Gardës Revolucionare, në përleshjet e armatosura, u vranë Mosa Khejabani, numri 2 i organizatës, Ashraf Rabi, gruaja e Masud Raxhavi dhe disa anëtarë të tjerë të Komitetit qendror. Me këtë ngjarje, pothuajse u mbyll periudha e ekzistencës së organizatës në Iran dhe në vitin 1983, edhe ato pak celula dhe persona të mbetur nga kjo organizatë, u zbuluan dhe u arrestuan.

#### **Qeveria e iluzionit në Paris dhe Bagdad**

Pas vendosjes së organizatës Moxhahedin-e Khalk në Francë, Abul Hasan Bani Sadr, president i shkarkuar i Iranit dhe Masud Raxhavi, filluan të

bashkëpunojnë për njëfarë kohe. Bani Sadr e konsideronte veten president të ligjshëm të Iranit dhe me një dekret personal, e emëroi

Masud Raxhaviun kryeministër të Iranit. Në atë epokë, kreu i organizatës, gruaja e të cilit ishte vrarë në Iran, ia hodhi sytë vajzës së mitur të Bani Sadrit dhe ky i fundit, ia dha vajzën e tij Firuzen Raxhaviut. Por kjo martesë zgjati shumë pak, pasi shumë shpejtë raportet e Raxhavit dhe Bani Sadrit u prishën. Sistemi i Republikës islamike duke arritur fitore të

njëpasnjëshme ushtarake kundër agresionit irakian, arriti të konsolidojë pozitën e tij dhe organizata nuk mundte të pretendonte më se brenda dy-tre muajsh të përmbyste pushtetin e të rikthehej në Teheran. Masud Raxhavi për të ngritur emrin e tij në mesin e anëtarëve të dëshpëruar të organizatës, mendoi një plan të ri bashkë me Merjem Kaxhar Asdanlu, gruan e Mehdi Abrishamchi, personit të dytë të organizatës dhe ky plan u quajt “revolucion ideologjik”. Në saj të këtij plani, organizata filloi të ngrejë pozitën e gruas dhe me urdhër të Raxhaviut, Abrishamchi u divorcua nga e shoqja dhe menjëherë pa i respektuar as rregullat fetare, Masud Raxhavi u martua me Merjemen. Kjo ngjarje e turpshme la edhe tek qarqet e huaja. P.sh. grupi “rruga e punëtorëve” i cili ishte një grup komunist, deklaroi se ky veprim ka lënduar thellë ndërgjegjen dhe moralin publik. Nga ana tjetër, Mehdi Abrishamchi deklaroi se kundërshtimi ndaj Masudit, është një veprim më i ulët sesa kundërshtimi i Zotit. Pas kësaj përlulesie të Abrishamchi, Raxhavi i dha atij Mina Khijabani, motra e Musa Khijabani, që ishte 12 vjet më e vogël e Abrishamchi dhe lejoi që ata të dy të martohen. Që nga ajo kohë, kombinacioni Masudi dhe Merjemi, zëvendësoi fjalën Masud në mesin e përkrahës të organizatës. Masud Raxhavi, në ceremoninë e dasmës, këtë eveniment e cilësoi si shpërthim i lirisë dhe theksoi: “Këtu bëhet fjalë për një shpërthim, për shpërthimin e lirisë”. Liderhipi i ri duke analizuar se superfuqitë nuk do të lejojnë që



Irani të dalë fitues në luftën me Irakun, vendosi të lërë mënjanë trupin dhe në mënyrë të hapur e zyrtare, të rreshtohet përkrah Sadamit. Në

mundi të mbajë gjallë këtë ushtri dhe ky revolucion i sajuar më nuk ka asnjë efekt për të shpëlarë trurin e forcave të humbura.



historinë politike të shteteve të botës, hasim shumë rrallë që një grup politik opozitar i një sistemi të krijojë një aleancë të tillë me armikun që ka sulmuar dhe synon pushtimin e vendit të tij dhe ta shesë veten tek armiku i popullit të tij. Pas negociatave fillestare mes Raxhavi dhe Tarek Aziz në Paris, organizata më 7 qershor 1986 u transferua në Bagdad. Që nga ajo kohë, Raxhavi dhe organizata e tij u vunë plotësisht në shërbim të regjimit të Sadamit dhe zbatuan pa asnjë kundërshtim çdo urdhër të Sadamit. Veprimi i parë i Raxhavi në Bagdad ishte krijimi i ushtrisë çlirimtare kombëtare. Kjo ushtri e vogël ishte në shërbim të Sadamit dhe misioni kryesor ishte kryerja e operacionit për rrëzimin e shtetit në Iran, vrasja e ushtarëve të pafajshëm në kufi, bombardimi i zonave të banuara, kryerja e sulmeve ndaj rajoneve jo ushtarake dhe vrasja e njerëzve të pafajshëm. Misioni i kësaj ushtrie në Irak, ishte zbatimi i operacionit Marvarid, vrasja e kurdëve, shtypja e shiitëve në jug të Irakut dhe të gjitha këto veprime vetëm e vetëm për të mbrojtur dhe shpëtuar Sadamin dhe për ta mbajtur atë në pushtet. Raxhavi gjithmonë në takimet dhe asamblatë e ndryshme paraqitej i veshur me rroba ushtarake me një pistoletë dhe me një shpatë. Ai kishte krijuar këtë të ashtuquajturën Ushtria Çlirimtare që në fakt ishte një kult terrorist i kryesuar prej tij dhe që kishte për qëllim vetëm rrëzimin e shtetit, kult që ai e quante të vetmen alternativë pasi të tjerët i quante tradhtarë të cilët i kërcënonte me vdekje. Tani kjo ushtri e ashtuquajtur çlirimtare, ka humbur armët, bazën strategjike Ashraf dhe duke dalë jashtë Irakut është kthyer në një luan pa kurorë, i lodhur dhe i dërrmuar. Kult i Raxhavi me revolucionin e sajuar të Marjam Raxhavi nuk

### Operacioni Mersad

Ushtria Çlirimtare Kombëtare nuk mundi të kryejë më shumë se disa operacione të kufizuara kundër Iranit në kufirin Iran-Irak. Operacioni më i rëndësishëm dhe njëkohësisht me idiot i Raxhaviut dhe i ushtrisë së tij të vogël, ishte operacioni i quajtur 'lavdi e përjetshme'.

Në ditët e fundit të luftës së imponuar nga Iraku kundër Iranit dhe pasi Irani pranoi rezolutën për armëpushim me Irakun, një pjesë e anëtarëve dhe përkrahësve të mashtuar të organizatës, u pajisën me armatime nga Sadami dhe të hipur në disa autobllinda mbi të cilët ishte stampuar logo e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të Iranit, nga rruga Khosravi-Khasreshirin, hynë në Iran dhe duke ecur me plotë shpejtësi në rrugën e asfaltuar, u nisën drejt Teheranit.

Atyre u kishin salduar në tru bindjes se kudo që të shkelin në Iran, populli do të bashkohet me ta dhe me ndihmën e popullit dhe të forcave të shumta përkrahëse të organizatës, do të mundin të avancojnë deri në Teheran. Por forcat ushtarake dhe popullore të Iranit, në një operacion të quajtur 'Mersad', që u zhvillua në gusht të vitit 1988, i asgjësuan të gjithë këta persona.

Operacioni 'lavdi e përjetshme' dështoi dhe ushtria e vogël e mohahedinëve u shpërnda. Ata terroristë që morën pjesë në këtë operacion u vranë dhe u arrestuan nga forcat ushtarake e popullore të Iranit.

Masud Rexhavi e dinte shumë mirë fundin e këtij operacioni, por megjithatë i detyroi disa anëtarë të vjetër të organizatës të cilët eventualisht kishin kundërshtime me të, të merrnin pjesë në këtë operacion, duke i shtyrë drejt vdekjes.

**K**rimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, që prej fillimit të aktiviteteve të këtij grupi, nuk përfshinë vetëm armiqtë e tij, por edhe vetë anëtarët e këtij grupi.

Megjithë këto krime, SHBA, në një veprim të papritur, e hoqën emrin e grupit terrorist MEK nga lista e zezë e grupeve terroriste. Pavarësisht motiveve politike që mund të fshihen pas këtij veprimi të SHBA, analizimi juridik i këtij veprimi dhe i krimeve të MEK, përfshin disa dimensione ligjore dhe juridike. Shqyrtimi i këtyre dimensioneve është i rëndësishëm për faktin se në krye të këtij grupi terrorist është po ai lidership që e ka udhëhequr këtë organizatë në krimet e saj më të shëmtuara dhe më çnjerëzore. Shtrohet pyetja: Vallë me kalimin e kohës, do të harrohen krimet e grupit terrorist MEK? Cilat janë dimensionet juridike të krimeve të MEK në një kohë që ky grup terrorist e ka ruajtur lidershipin e tij, dhe cilat janë bazat juridike të heqjes së emrit të MEK nga lista e grupeve terroriste të SHBA?

Analizimi i dimensioneve juridike të krimeve të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk mund të kryhet në dy aspekte: Së pari, krimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk kundër iranianëve dhe së dyti, krimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk kundër joiranianëve. Shumica e ekspertëve dhe e juristëve, krimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk në disa raste si krimet kundër kurdëve të Irakut, i cilësojnë si shembuj të qartë të gjenocidit. Por meqenëse për përcaktimin e një krimi si gjenocid është e nevojshme të analizohen kushtet rrethanore dhe mendore të krimit, është vështirë që krimet e MEK të formulohen juridikisht me termin “gjenocid”. Sidoqoftë, ajo që është mëse e qartë është fakti se krimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk, pa asnjë dyshim përbëjnë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ndarja mes krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera nga MEK është e mundur duke analizuar rrethanat luftarake dhe joluftarake në të cilat janë kryer krimet monstruoze të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Me fjalë të tjera, krimet e kryera nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk kundër ushtrisë, Gardës Revolucionare

dhe forcave vullnetare iraniane në rrethanat e luftës, konsiderohen krime lufte, ndërsa krimet e kryera ndaj popullatës civile në kohë lufte dhe paqe quhen krime kundër njerëzimit. Duke pasur parasysh këtë ndarje mund të analizohen krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Gjithashtu, e ndarë mund të kryhet edhe analiza e krimeve të MEK kundër iranianëve dhe joiranianëve. Krime lufte konsiderohen veprimet që shkelin konventat ndërkombëtare përsa u përket rregullave të luftës. Këtu përfshihen vrasjet, keqtrajtimet, dëbimet e dhunshme të banorëve të zonave të pushtuara, keqtrajtimi i robërve dhe shfrytëzimi i tyre për punë të detyruar, vrasja e pengjeve, plaçkitja e pasurive të banorëve të fshatrave apo qyteteve të pushtuara. Sipas organizatës Human Rights Watch, “sulmi i qëllimshëm kundër civilëve në zonat e luftës konsiderohet krim lufte.” Duke pasur parasysh luftërat që grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk ka zhvilluar kundër sistemit të Republikës Islamike të Iranit dhe kundër popullit iranian. Mund të thuhet me siguri se krimet e kryera nga MEK kanë qenë krime lufte. Mbase disa pretendojnë se në kushtet e luftës dhe konfliktit mes forcave revolucionare dhe anti-revolucionare, ndodhin përplasje që mund të konsiderohen si një lloj reagimi reciprok, por duke u bazuar në raportet mbi veprimet e MEK deri në vitin 1989 dhe sidomos mbi veprimet e këtij grupi terrorist gjatë operacionit Mersad, të cilin ky grup e emëroi “Flaka e përjetshme”, padyshim veprimet e MEK mund të quhen krime lufte. Në bazë të vëzhgimeve dhe raporteve të Human Rights Watch, terroristët e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk qëllimisht kanë sulmuar banorët e rajonit Islamabad në perëndim të Iranit. Përveç kësaj, arrestimi i burrave dhe masakrimi i tyre nën akuzën e mosbashkëpunimit, shkatërrimi i fshatrave përreth këtij qyteti dhe shkatërrimi i pjesës më të madhe të Islamabadit, në bazë të ligjeve dhe konventave ndërkombëtare konsiderohen krime lufte. Megjithëse grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk pretendon se shkatërrimet dhe plaçkitjet janë kryer nga forcat ushtarake të republikës islamike të Iranit, faktet dhe dëshmitë tregojnë se në atë periudhë forcat iraniane ishin krejtësisht në pozita mbrojtëse, ndërsa raxhivistët dhe mercenarët e regjimit të Sadam Huseinit po kryenin operacione sulmuese kundër Iranit duke treguar një egërsi dhe mizori të paparë me qëllim që të krijonin panik te popullsia civile dhe të dobësonin moralin e luftëtarëve iranianë. Sigurisht krimet e kryera nga



grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk gjatë operacionit Mersad janë krime lufte, të cilat duhet të ndiqen juridikisht dhe penalisht. Krimet e luftës janë formuluar plotësisht dhe tepër qartë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, në Konventën e Gjenevës dhe në ligjet ndërkombëtare dhe të gjitha krimet e kryera nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk përputhen plotësisht me këtë formulim. Qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare në kriza të ndryshme si ajo në Darfur dhe në Sierra Leone, tregojnë për faktin se rebelët që kundërshtojnë një sistem politik lejohen të kryejnë krime lufte dhe këto krime tolerohen nga bashkësia ndërkombëtare. Në ligjet dhe konventat ndërkombëtare, krime kundër njerëzimit konsiderohen vepra të tilla si vrasjet masive të civilëve, arrestimi, keqtrajtimi dhe dëbimi masiv i popullatës, dënimi kolektiv dhe vrasja masive e popullatës civile nisur nga motive etnike dhe fetare. Veprimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk përputhen plotësisht me këtë formulim juridik dhe për vërtetimin e këtij fakti mjafton të përmendim masakrimin e kurdëve të Irakut në tragjedinë e Kirkukut dhe bashkëpunimin e ngushtë të MEK me regjimin e Sadamit në masakrimin dhe terrorizimin e popullsisë shiite dhe kurde të Irakut. Analizimi i këtyre krimeve ka rëndësi të madhe, sepse hedh poshtë pretekstet e MEK si një organizatë “çlirimtare” që lufton kundër një populli dhe kundër një pushteti. Përsa u përket krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, MEK nuk mund të marrë pozita mbrojtëse. Në rastin e operacionit Mersad, grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk ka qenë në pozitë sulmuese dhe në bashkëpunim me regjimin e Sadamit ka kryer krime kundër popullsisë së një shteti tjetër. Përveç kësaj, faktet dhe dëshmitë e mbledhura flasin qartë se krimet e kryera nga MEK janë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Vrasja e 183 mijë kurdëve irakianë në qytetin Kirkuk u krye nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk në bashkëpunim me forcat e regjimit të Sadamit. Për të fshehur gjurmët

e këtij krimi kundër njerëzimit, MEK përdori metoda dinake si veshja e rrobave kurde dhe shfrytëzimi i pamjeve të liderëve kurde e në veçanti të Xhelal Talebanit dhe Masud Barzanit. Të tilla metoda janë përdorur nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk deri në vitin 1989, por kanë ngjashmëri të madhe me taktikat e përdorura në vitin 1981 ku terroristët e këtij grupi visheshin si gra dhe kryenin akte të shëmtuara terroriste në rrugët e Teheranit.

Masakrimi i kurdëve irakianë, varrosja për së gjalli e fëmijëve, dëbimi i detyruar i kurdëve dhe internimi masiv i tyre në zonat jugore të Irakut, torturimi dhe keqtrajtimi mizor dhe sistematik i kurdëve, janë krimet kundër njerëzimit të kryera nga MEK kundër etnisë kurde të Irakut dhe në favor të etnisë arabe baathiste që ishte aleate e Sadamit. Edhe krimet monstruoze të grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk kundër popullsisë shiite në jug të Irakut ishin krime kundër njerëzimit që kishin për qëllim dobësimin e pozitës së shiitëve përballë sundimit të sunitëve. Në bazë të ligjeve të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, krimet e grupit terrorist Muxhahedin-e-Khalk nuk mund të ndiqen penalisht nga drejtësia ndërkombëtare për shkak se ky grup nuk është një shtet apo qeveri. Ndjekja penale e krimeve të MEK bëhet edhe më e vështirë në kushtet kur SHBA dhe BE, në vazhdim të qëndrimeve të tyre dyfytyrëshe ndaj terrorizmit, e kanë hequr grupin MEK nga lista e grupeve terroriste. Megjithatë, kalimi i kohës nuk do të lërë në harresë krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera nga grupi terrorist Muxhahedin-e-Khalk. Organet e drejtësisë në Iran dhe Irak do të ndjekin dosjen e madhe të krimeve të MEK për të denoncuar karakterin terrorist dhe kriminel të këtij grupi. Mosndjekja juridike dhe penale e krimeve të grupit terrorist

Muxhahedin-e-Khalk dhe lënia në harresë e viktimave të krimeve të këtij grupi, do të ketë pasoja negative për drejtësinë ndërkombëtare dhe kjo neglizhencë hap rrugën për krime të tjera nga kriminelët e padënuar.



**P**arstoday është një sajt informativ iranian, i cili duke shfrytëzuar përvojën mbi 70 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm të RTV të Iranit (IRIB Worldservice), ka filluar në një formë të re mediatike aktivitetin e tij në Janar 2016, duke transmetuar në mbi 30 gjuhë të botës lajme dhe informacione mbi zhvillimet kryesore në rajon dhe të botë.

Parstoday posedon shërbime mediatike si website, radio, transmetim përmes valëve në frekuenca, në internet dhe në celular si dhe në rrjetet sociale. Parstoday i transmeton informacionet për publikun në gjuhët shqip, arabisht, armene, bengale, kineze, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, husa, hebreje, indiane, indoneziane, italisht, japoneze, kazake, savahili, pashtun, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht dhe numri i redaksive në gjuhë të huaja do të shtohet.

Zhvillimet politike në Lindjen e Mesme dhe roli i rëndësishëm i Iranit si një vend ndikues në rajon dhe si një vend i sigurt dhe në zhvillim, e shton edhe më shumë rëndësinë e Parstoday si një media me ndikim.

Parstoday në gjuhën shqipe ofron për publikun programe dhe emisione me tematika informative, politike, kulturore dhe fetare duke informuar opinionin me të pathënat e mediave botërore.

Programet e Parstoday në gjuhën shqipe ofrohen për miliona shqiptarë në rajonin e Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të botës, të cilët janë të interesuar të njihen realisht me zhvillimet në Iran, në lindjen e Mesme dhe në vendet banuara nga popullsia shqiptare.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me ne.

## Parstoday.com/sq



[albanian@parstoday.com](mailto:albanian@parstoday.com)

Tel: +98-21-22162833

Tel: +98-21-22162716

Celular: +98-903-5065501



[facebook.com/ParsTodayAlbanian](https://facebook.com/ParsTodayAlbanian)



[instagram.com/parstodayalbanian](https://instagram.com/parstodayalbanian)



[@ParsTodaySq](https://twitter.com/ParsTodaySq)